



Teksti zyrtar siç është amendamentuar me 11.11.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të kreut XIII, XVI dhe nenit 64.2 pika (a) dhe (b) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe kreut XIII, XVI dhe nenit 20 Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nxjerr:

**RREGULLËN ZGJEDHORE Nr. 09/2009
VOTIMI DHE NUMËRIMI BRENDA VENDVOTIMEVE NË NIVELIN E
KOMISIONIT KOMUNAL ZGJEDHOR**

**Neni 1
Përkufizimet**

1.1 Vendvotimi (VV) do të thotë një dhomë, sallë ose objekt i ngjashëm për qëllime të votimit në Ditën e Zgjedhjeve.

1.2 Qendra e votimit (QV) është ndërtesa në të cilën ndodhen një ose më shumë Vendvotime për qëllim të votimit në zgjedhje dhe përfshinë një hapësirë publike dhe private brenda hapësirës prej 25 metra nga dera e ndërtesës.

1.3 Me Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV) nënkuptohet Lista e Votuesve e përcaktuar në bazë të nenit 8.6 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës .

1.4 Me Listën e Votuesve me Kusht (LVK) nënkuptohet lista e zbrazët e votuesve që do të përdoret në VV-të ku hidhen Fletëvotimet me Kusht.

1.5 LPV-ja e votuesve që caktohen në QV-në e njëjtë do të ndahet nëpër VV-të e veçanta me renditje alfabetike sipas mbiemrit. VV nuk duhet të tejkalojë numrin prej 750 votuesve. Përjashtimet nga kjo Rregull mund të rekomandohen - autorizohen nga Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për t'u shërbyer më mirë interesave të votuesve.

1.6 Vendvotimi i fundit në çdo QV do të shërbejë si VV për votimin me kusht dhe quhet vendvotimi i dyfishtë (VVD). Në QV-në me një VV, i njëjti VV do të shërbejë edhe për votim me kusht.

1.7 Në çdo VV duhet të caktohet një Këshill i Vendvotimit (KVV) i cili do të udhëheq dhe mbikëqyr procesin e votimit, dhe numërimit. Sipas vendimit të KQZ-së, mund të formohet një KVV i dytë përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve. Në këtë rast ekipi parë i KVV-së do të jetë Ekipi i Votimit dhe do të jetë përgjegjës për VV gjatë orarit të votimit, dhe ekipi i dytë do të jetë Ekipi Numrimit dhe do të jetë përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve pas mbylljes së VV.

1.8 Çdo QV duhet të ketë nga një menaxher të QV-së, i cili duhet të sigurojë që QV-ja të jetë e përgatitur për Ditën e Zgjedhjeve, të sigurojë qasje në QV dhe të ndërlidhet me KKZ-në sa i përket transportimit të materialit të zgjedhjeve për në QV dhe anasjelltas.

1.9 Secili anëtar i KVV-së dhe KKZ-së duhet ta nënshkruaj Kodin e Mirësjelljes dhe të veproj në pajtim me te.

1.10 Çdo QV që ka deri në gjashtë (6) VV duhet të ketë nga një (1) ekip të tavolinës ndihmëse të QV-së të përbërë nga dy njerëz. QV-të prej shtatë (7) deri në dymbëdhjetë (12) VV duhet të kenë dy (2) ekipe të tavolinës ndihmëse të QV-së. Tavolinat ndihmëse duhet të pajisen nga SKQZ-ja me lista komunale të votuesve që përmbajnë të gjithë njerëzit me të drejtë vote në atë komunë, të klasifikuar sipas alfabetit dhe ku saktësohet VV-ja ku ata janë caktuar.

Neni 2

Lokacionet e Qendrave të Votimit dhe Vendvotimeve

2.1 Në bazë të rekomandimit të komisionit komunal të zgjedhjeve (KKZ), KQZ-ja, përmes Sekretariatit të KQZ-së, do të shpall publikisht lokacionin e saktë të të gjitha QV-ve, jo më vonë se dyzet (40) ditë para zgjedhjeve.

2.2 Asnjë votues mundësisht, nuk duhet të udhëtoj më shumë se 3 km deri në vendvotimin e tij apo të saj.

2.3 Ndryshimet pasuese të lokacioneve të QV-ve do të lejohen në rast të *fuqisë madhore* ose për shkaqe të tjera objektive dhe të paparashikuara që do ta bënin një QV të papërshtatshme për qëllime votimi. Sekretariati i KQZ-së duhet që menjëherë ta informojë KQZ-në për këto ndryshime.

2.4 Nëse lokacioni i QV-së është ndryshuar, KKZ-ja duhet t'i njoftojë votuesit për atë ndryshim përmes mediave vendore. Përveç kësaj, KKZ-ja do të vendosë një njoftim në lokacionin fillestar të QV-së me të cilin i njofton votuesit për lokacionin e ri të QV-së.

2.5 QV-ja ose VV-ja nuk duhet të vendoset në një objekt fetar, ndërtesë që është pronë ose seli e ndonjë subjekti politik, ose në objekte në të cilat shërbehet ose konsumohet alkooli.

2.6 VV-të do të vendosen në një vend të përshtatshëm për hyrje-dalje, për t'u mundësuar votuesve të krijojnë rresht dhe të qëndrojnë në të, dhe kur është e mundur, vendi për hyrje-dalje të jetë i rrafshët, ashtu që personat me aftësi të kufizuara të mund të hyjnë dhe të dalin në mënyrë të papenguar. VV-të duhet të kenë ndriçim adekuat dhe mbrojtje nga fatkeqësitë elementare.

2.7 VV-ja duhet të jetë mjaft e madhe që të sigurojë zhvillim të rregullt të votimit duke vendosur të gjitha tavolinat e punës e definuara në këtë Rregull dhe duke siguruar fshehtësinë e votimit, shikimin dhe kontrollin e lirë të kutisë së votimit dhe qasje të papenguar për vëzhguesit.

2.8. Në VV dhe në QV gjatë Ditës së Zgjedhjeve mund të jenë të pranishëm personat e autorizuar si ne vijim:

- a personat me qëllim të votimit
- b anëtarët e KVV-së dhe stafi i QV-ve
- c anëtarët e KQZ-së dhe SKQZ-së
- d anëtarët e KKZ-së që veprojnë në komunën e tyre
- e vëzhguesit e akredituar
- f policia, kur thirret për të vendosur rregull, dhe
- g përkthyesit për personat e shënuar në pikat (c), (e) dhe (f) të këtij paragrafi

2.9 Mundësisht, në çdo QV duhet të ketë edhe shablone me alfabetin e Brajl-it dhe anëtarë të trajnuar për votimin e personave të verbër të cilët do t'u shërbejnë votuesve të verbër në atë QV.

Neni 3 Roli i Vëzhguesve

3.1 Gjithë procesi i hapjes, votimit, përfundimit, dhe procesi i numërimit, me përjashtim të shënimit të fletëvotimit nga votuesi, e gjithashtu edhe paketimi dhe dorëzimi i materialit nga VV/QV të KKZ-ja dhe nga KKZ-ja deri në Qendrën e Numrimit dhe Rezultateve mund të vëzhgohet nga anëtarët e KQZ-së, personeli i Sekretariatit të KQZ-së, anëtarët e KKZ-ve që veprojnë në kuadër të komunave të tyre, si dhe nga vëzhguesit e akredituar. Përshkrimi i procesit të akreditimit, për tu bërë vëzhgues i zgjedhjeve është definuar në rregullën zgjedhore nr. 07/ 2009 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve.

3.2 Jo më shumë se dy vëzhgues nga organizata e njëjtë e akredituar mund të jenë prezent në të njëjtën kohë brenda në VV.

3.3 Pa marr parasysh dispozitat e kësaj Rregulle, nëse Kryesuesi i KVV-së është i mendimit se numri i vëzhguesve të akredituar të pranishëm brenda në VV- është duke e penguar procesin e votimit ose të numërimit, ai/ajo duhet t'i udhëzojë vëzhguesit e akredituar që të zvogëlojnë numrin e tyre.

Neni 4 Libri i Votimit

4.1 Çdo VV do të ketë nga një libër të votimit në të cilin do të shënohen informatat e rëndësishme përkitazi me zhvillimin e votimit.

4.2 Vetëm Kryesuesi i KVV-së, anëtarët e KVV dhe vëzhguesit e akredituar do të lejohen të shënojnë vërejtjet e tyre në Librin e Votimit. Nëse votuesi ka ndonjë ankesë përkitazi me aktivitetin në kuadër të VV-së, ai/ajo duhet të kërkojë nga Kryesuesi i KVV që në Librin e Votimit ta shënojë ankesën e tij/saj, dhe/ose të dorëzojë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në përputhje nenin 119 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe procedurat e përcaktuara nga PZAP-i.

Neni 5 Siguria në Vendvotim

5.1 Kryesuesi i KVV-së, me ndihmën e të gjithë anëtarëve të KVV-ve, duhet të sigurojë qetësi dhe siguri në procesin e votimit brenda VV-së. Rendi në rresht para VV-së do të mbahet nga një anëtar i KVV-së që caktohet si kontrollues i rreshtit.

5.2 Në rast të ndonjë çrregullimi serioz brenda VV-së ose në rrethinën e afërt të saj, kryesuesi i KVV duhet të kërkojë ndihmë të menjëhershme nga policia. Ky rast duhet të shënohet menjëherë në Librin e Votimit.

5.3 Në rast se çrregullimi bëhet kërcënim serioz për integritetin e procesit të votimit ose për njerëzit brenda VV-së, kryesuesi i KVV mund të vendosë ta pezullojë votimin dhe ta mbyllë VV-në deri sa të rivendoset rendi. Kryesuesi duhet që menjëherë ta informojë KKZ-në dhe ta shënojë ngjarjen në Librin e Votimit, duke përfshirë kohën gjatë të cilës është pezulluar votimi.

5.4 Asnjë person që bartë armë, nuk do të lejohet brenda në VV, përveç personelit të Policisë së Kosovës që siguron ndihmë për rivendosje të rendit brenda VV-së.

5.5 Pjesëtarët e armatosur e të uniformuar të Policisë të Kosovës mund të lejohen të hyjnë në VV për të votuar, por nuk mund të qëndrojnë brenda VV-së pasi të kenë votuar.

Neni 6 Materiali i fushatës së Zgjedhjeve dhe Materiali për Informim të Votuesve

në Vendvotime dhe në Qendra të Votimit

6.1 Së paku 24 orë para fillimit të votimit, KVV-ja do të largoj çfardo material të fushatës zgjedhore, nëse ndonjeri është vendosur brenda dhe rreth cilit do VV ose QV në rreze prej 100 metrave. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialin e fushatës zgjedhore deri 24 orë para fillimit të votimit ose janë gjetur duke postuar materialin e fushatës zgjedhore pas afatit kohor të caktuar, KVV-ja të raporton në PZAP duke përdorur Formularin e PZAP-it për ankesa, menjëherë pasi që shkelja është paraqitur.

6.2 Asnjë informatë e fushatës zgjedhore nuk do të transmetohet në asnjë pajisje komunikimi në VV apo QV, dhe as në distancë të dëgjueshme. Një veprim i tillë do të raportohet nga KVV-ja në PZAP menjëherë pasi që shkelja të jetë bërë.

6.3 Çdo material i shtypur i zgjedhjeve, i përgatitur nga Sekretariati i KQZ-së në emër të KQZ-së, që ka listuar të gjitha subjektet e certifikuar politike dhe të gjithë kandidatët e certifikuar duhet të ekspozohet nëpër VV-të dhe në derën kryesore të hyrjes të çdo QV-je, për të mirën e votuesve.

6.4 Shenjat informuese në ndërtesë duhet të paraqesin qartë numrin e QV-së. Shenjat që i drejtojnë votuesit në VV-në e saktë duhet të ekspozohen në vende të dukshme brenda QV-së. Çdo VV duhet të shënohet qartë me shenja të cilat tregojnë numrin e VV-së dhe shkronjën fillestare të mbiemrit të atyre votuesve nga LPV-ja, që janë të caktuar në atë VV.

Neni 7

Procedurat Para se të Fillojë Votimi

7.1 Deri më orën 06:00 në Ditën e Zgjedhjeve, në hapësirat e KKZ-së, Kryesuesi i KVV-së dhe njëri nga anëtarët e KVV-së, i cili do të veprojë si zëvendëskryesues gjatë gjithë procesit, do të:

(a) t'i kontrollojë të gjitha materialet nga KKZ-ja, duke përfshirë LPV-në dhe/ose LVK-në e zbrazët, zarfat e fletëvotimeve me kusht, fletëvotimet, kutitë e votimit, kabinat e votimit, llambën ultravjollce dhe ngjyrën e padukshme, vulën zyrtare të fletëvotimit, ngjyrën, mbushësit e ngjyrës, librin e votimit dhe materialin për zyrë; dhe

(b) të plotësojë dhe të nënshkruajë formularin e Dorëzimit-Pranimit të Materialit, kopja e së cilës është bashkangjitur në Shtojcën I, duke vërtetuar numrin e fletëvotimeve, LPV dhe materialin egzistues; dhe

(c) t'i dërgojë materialet e renditura si në pikën (a) të këtij neni nga KKZ-ja në QV nën përcjellje të policisë.

7.2 Të gjithë anëtarët e KVV-së duhet të jenë të pranishëm në VV, së paku një orë para (orës 6:00) hapjes së votimit (orës 7:00).

7.3 Para hapjes së VV-së, kryesuesi i KVV-së duhet të:

(a) informojë KKZ-në për cilindo anëtar të KVV-së që mungon dhe të kërkojë zëvendësim. Nëse mungon kryesuesi, atëherë anëtari i KVV- së që vepron si zëvendëskryesues duhet ta zëvendësojë kryesuesin dhe të kërkojë nga KKZ-ja që të sigurojë zëvendësimin për anëtarin e KVV-së. Një VV do të lejohet të hapet me një numër minimal prej tre (3) anëtarësh të KVV-së;

(b) verifikojë dhe shënojë numrin e gjithmbarshëm të fletëvotimeve të marra në formularin e përputhjes së të dhënave dhe të rezultateve (FPR), që janë të bashkangjitura në këtë Rregull si Shtojcë II.

(c) përgatisë dhe ekspozojë kutinë e zbrazët të votimit në prani të anëtarëve të KVV-ve dhe të cilitdo vëzhguesi të akredituar që mund të jetë i pranishëm, pastaj kutinë e votimit ta mbyll me shiritin(at)

mbyllës të siguruar për këtë qëllim, dhe të shënojë numrin serik të shiritit(ave) mbyllës të kutisë së votimit në FPR-të.

(d) shënojë në Librin e Votimit emrat dhe numrat personalë të letërnjoftimeve të të gjithë anëtarëve të KVV-së;

(e) shënojë në librin e votimit, emrat, numrat personalë të letërnjoftimeve dhe numrat e akreditimit (distinktivëve të vëzhguesve) të të gjithë vëzhguesve të akredituar të pranishëm dhe t'u rikujtojë atyre obligimet dhe të drejtat e tyre si vëzhgues; dhe

(f) sigurojë se materiali i fushatës është hequr dhe se është vendosur materiali për informim lidhur me votimin, siç përcaktohet në nenin 6 të kësaj rregulle.

7.4 Nëse VV-ja hapet me vonesë, kryesuesi i KVV-së duhet që menjëherë ta njoftojë KKZ-në, e cila pastaj do ta informojë Sekretariatit e KQZ-së. Kryesuesi i KVV-së gjithmonë do të shënoj kohën e hapjes së VV-së në Librin e Votimit, e në rastin e vonesës gjithashtu ai/ajo do ta shënojë arsyen e vonesës në Librin e Votimit.

Neni 8 Orari i Votimit

8.1 Të gjitha VV-të do të hapen në orën 07:00 dhe do të mbyllen në orën 19:00.

8.2 Askush nuk mund të votojë pas kohës së mbylljes së qendrave të votimit, përveç votuesve të cilët presin në radhë në VV në kohën e mbylljes.

Neni 9 E drejta e Votës dhe Fshehtësia e Votës

9.1 Votuesi me zotësi juridike ka të drejtë vote në Kosovë në Ditën e Zgjedhjeve, me kusht që ai/ajo është regjistruar si banor i përhershëm i Kosovës, në ditën e specifikur nga KQZ-ja .

9.2 Asnjë person nuk duhet ta parandalojë ose të orvatet ta parandalojë një votues me zotësi juridike nga ushtrimi i së drejtës së tij/saj për të votuar.

9.3 Asnjë person nuk duhet të lejohet të votojë në emër të një votuesi tjetër, përveq në rastin siç është përcaktuar në nenin 9.5 të kësaj rregulle zgjedhore.

9.4 Çdo votues duhet të shënoj fletëvotimin e vet në fshehtësi mbrapa kabinës së votimit. Vetëm një person do të lejohet të qëndroj pas kabinës së votimit, në çdo kohë, vetëm nëse votuesi ka kërkuar ndihmë nga personi tjetër, siç është përcaktuar në nenin 9.5 të kësaj rregulle zgjedhore.

9.5 Votuesit me aftësi të kufizuar në atë mënyrë që ai/ajo nuk është i aftë për ta shënuar fletëvotimin, dhe/ose analfabet mund t'i ofrohet ndihmë për të votuar nga një person tjetër që zgjidhet nga votuesi, nëse ai kërkon një ndihmë të tillë. Personi i tillë duhet t'i ndihmojë vetëm një votuesi dhe nuk duhet të jetë anëtar i KVV ose vëzhgues i akredituar. Ndihma që i jepet votuesit do të merret parasysh vetëm në rrethana të veçanta dhe duhet të monitorohet nga afër nga kryesuesi i KVV ose zëvendësi i tij/saj.

9.6 Personi i cili ka pranuar të asistojë votuesin do të shënojë me shkronja të shtypit emrin e tij/saj dhe do të nënshkruaj në Listën Votuese përkatëse, pranë emrit ose hapsirës të votuesit që është asistuar.

9.7 Anëtarët e KVV-së nuk mund në asnjë mënyrë të ndikojnë në vendimin e votuesit dhe do të kenë kujdes të veçantë të sigurojnë që votuesi nuk do të shqetësohet nga askush gjatë shënimit të fletëvotimit(ve) dhe që fshehtësija e votimit është siguruar plotësisht.

9.8 Anëtarët e KVV-së do të shpjegojnë procedurën e votimit vetëm nëse u kërkohet nga votuesit, por do ta drejtojnë votuesin sipas procedurave të votimit për të garantuar një proces efikas të votimit.

Neni 10

Dokumentet e Pranueshme të Identifikimit

Për qëllime të zgjedhjeve, dokumente të pranueshme për identifikim janë, si vijon:

- (a) dokument i identifikimit (DI) i vlefshëm;
- (b) pasaporti i vlefshëm;
- (c) dokumenti i vlefshëm i udhëtimit;
- (d) leja e vlefshme e vozitjes e Kosovës;
- (e) kartela e vlefshme e PZHBV-së; ose
- (f) kartela e vlefshme e refugjatit.

Neni 11

Votimi i Rregullt

11.1 Para se votuesit të lejohen të hyjnë brenda në VV, kontrolluesi i rreshtit do të kontrollojë nëse ka njollë të ngjyrës së padukshme në gishtërinjtë e votuesve. Cilido votues në gishtin e të cilit gjendet njolla e ngjyrës së padukshme, nuk do të lejohet të hyjë në VV.

11.2 Sapo votuesi të jetë lejuar të hyjë brenda në VV, ai/ajo do të udhëzohet për te anëtari i caktuar i KVV-së, i cili duhet ta verifikojë identitetin e votuesit - duke i kërkuar atij/asaj që të paraqesë njërin nga dokumentet e pranueshme të identifikimit, siç përcaktohet në nenin 10 të kësaj rregulle zgjedhore. Nëse votuesi nuk mund të paraqesë asnjërin nga dokumentet e përcaktuara qartë në nenin 10 të kësaj rregulle zgjedhore, votuesi duhet të informohet se ai/ajo nuk mund të votojë, dhe Kontrolluesi i rreshtit do ta përcjellë atë jashtë VV-së.

11.3 Pastaj kontrollohet se a gjendet emri dhe mbiemri i votuesit në LPV.

(a) Nëse emri dhe mbiemri i votuesit nuk figuron në LPV, votuesi do të këshillohet që ta vizitojë tavolinën ndihmëse të QV-së për të mësuar se në cilin VV është caktuar të votojë, ndërsa kontrolluesi i rreshtit e përcjellë atë jashtë VV-së; ose

(b) Nëse emri dhe mbiemri i votuesit gjendet në LPV me një shenjë ose shënim që tregon se votuesi duhet të votojë me kusht, atëherë votuesi duhet të votojë vetëm me fletëvotim me kusht dhe do të drejtohet për te VV-ja e dyfishtë.

11.4 Nëse emri dhe mbiemri i votuesit gjendet në LPV, pa një shenjë ose shënim, votuesi duhet të udhëzohet që të nënshkruajë në LPV pranë emrit të tij/saj;

11.5 Pasi që votuesi të nënshkruajë në LPV, atij/asaj duhet t'i spërkatet gishti i djathtë tregues, ose cilido gisht tjetër nëse nuk ka gisht tregues, dhe pastaj votuesi pajiset me një fletëvotim të vetëm të vulosur për zgjedhje.

Votuesi i cili refuzon që t'i spërkatet gishti me ngjyrë të padukshme ose të nënshkruajë në LPV, nuk do t'i jepet fletëvotimi dhe kontrolluesi i rreshtit do ta përcjellë atë jashtë VV-së. Ky incident duhet të shenohet në Librin e Votimit.

11.6 Pasi që votuesit t'i jetë dhënë fletëvotimi(et), të zgjedhjet (ve) përkatëse, ai/ajo do të udhëzohet të shkojë te njëra nga kabinat e votimit për të shënuar fletëvotimin(et) në fshehtësi.

11.7 Prapa secilës kabinë të votimit gjendet nga një broshurë me emrat e kandidatëve për Zgjedhjet e Kuvendit Komunale dhe/ose të Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës. Votuesi mund ta informojë kryesuesin e KVV nëse mungon ndonjë broshurë, faqet janë të grisura nga broshura, ose nëse në

broshurë ka shënime të shkruara. Kryesuesi duhet t'ia sigurojë votuesit broshurën e re, kur një gjë e tillë është e përshtatshme.

11.8 Nëse votuesi e ka dëmtuar fletëvotimin e vet, ai/ajo duhet ta dorëzojë fletëvotimin e dëmtuar dhe të kërkojë një fletëvotim të ri të vulosur. Anëtari i KVV duhet ta bëjë me shenjë atë fletëvotim, duke shkruar "i dëmtuar" në anën e prapme të tij dhe duhet ta mbajë atë në një zarf të dizajnuar posaçërisht për këtë qëllim.

11.9 Pas shënimit të fletëvotimit, votuesi duhet ta vendosë fletëvotimin në kutinë e votimit, ashtu që të mund të shihet nga mbikëqyrësi i kutisë së votimit dhe pastaj ai/ajo menjëherë largohet nga VV-ja.

11.10 Në çdo VV duhet të ketë një kuti votimi për çdo nivel të zgjedhjeve. Në kutinë e votimit duhet të shënohet qartë Kodi i VV për të identifikuar çartë se për cilat zgjedhje janë të përcaktuara. Mbikëqyrësi i kutisë së votimit duhet të sigurojë që votuesit e vendosin vetëm fletëvotimin në kutinë e votimit.

11.11 Mbikëqyrësi i kutisë së votimit nuk duhet ta lejojë asnjë votues që të largohet nga VV-ja pa e vendosur fletëvotimin e pranuar në kutinë(të) e votimit. Refuzimi që të veprohet në përputhje me këtë kërkesë nga votuesi, konsiderohet shkelje e dispozitave ligjor në zbatim .

11.12 Votimi në të njëjtën zgjedhje më shumë se një here paraqet veper penale dhe është e dënueshme në pajtim me Kodin Penal të Kosovës.

Neni 12 Votimi me Kusht

12.1 Votuesi në Kosovë, emri dhe mbiemri i të cilit nuk mund të gjendet në LPV, ose që emri i tij/saj gjendet në LPV me një shenjë ose shënim që tregon se ai/ajo duhet të votojë me kusht, duhet të lejohet të votojë me kusht në VV-në e dyfishtë, me kusht që identiteti i tij/saj të mund të verifikohet sipas nenit 10 të kësaj rregulle.

12.2 Anëtari i KVV- së, në Listën e Votuesve me kusht (LVK) do të shënojë emrin dhe mbiemrin e votuesit, si dhe njëzën nga të dhënat në vijim:

- (a) numrin personal të DI të tij/saj, ose
- (b) datën e tij/saj të lindjes.

12.3 Pas shënimit të të dhënave personale të votuesit në LVK, anëtari i KVV- së duhet që informatat e njëjta t'i shkruajë në zarfin e fletëvotimit me kusht, ndërkaq votuesi duhet të udhëzohet të nënshkruajë në LVK pranë emrit të tij/saj.

12.4 Pasi që votuesi të ketë nënshkruar në LVK, atij/asaj duhet t'i spërkatet gishti i djathtë tregues, ose cilindo gisht tjetër nëse nuk ka gisht tregues, dhe pastaj votuesit do t'i jepet fletëvotimi i vulosur për zgjedhjet përkatëse, gjersa anëtari i KVV- së e mban dokumentin e identifikimit të votuesit dhe zarfin e fshehtësisë. Votuesit i cili refuzon t'i spërkatet gishti me ngjyrë të padukshme ose ta nënshkruajë LVK-në, nuk do t'i jepet fletëvotimi(et) dhe kontrolluesi i rreshtit do ta përcjellë atë jashtë VV-së. Ky rast duhet të shënohet në Librin e Votimit.

12.5 Pasi që votuesit t'i jetë dhënë fletëvotimi, ai/ajo duhet të udhëzohet të shkojë në njëzën nga kabinat e votimit për të shënuar fletëvotimin në fshehtësi. Zarf i plotësuar i fletëvotimit me kusht, zarfin e fshehtësisë dhe dokumenti i identifikimit të votuesit duhet t'i jepen mbikëqyrësit të kutisë së votimit.

12.6 Nëse votuesi e ka dëmtuar fletëvotimin e vet, ai/ajo duhet ta dorëzojë fletëvotimin e dëmtuar dhe të kërkojë fletëvotim të ri të vulosur për zgjedhjet përkatëse. Anëtari i KVV- së duhet ta bëjë me

shenjë fletëvotimin e dëmtuar, duke shkruar “i dëmtuar” në anën e prapme të tij dhe duhet ta mbajë atë në një zarf të dizajnuar posaçërisht për këtë qëllim.

12.7 Pas shënimit të fletëvotimit, votuesi në prani të mbikëqyrësit të kutisë së votimit, e vendos fletëvotimin në një zarf të fshehtësisë dhe i mbyll zarfet. Pastaj votuesi, zarfin e fshehtësisë e vendos brenda zarfit të plotësuar të fletëvotimit me kusht, e mbyll dhe e vendos atë në kutinë e votimit të caktuar për zarfet e fletëvotimeve me kusht.

Pastaj mbikëqyrësi i kutisë së votimit ia kthen votuesit dokumentin e tij/saj të identifikimit.

Neni 13

Votimi i Anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit

13.1 Anëtarët e KVV-ve dhe Kryesuesi votojnë të parët kur hapet vendvotimi.

Nëse një anëtar i KVV- së nuk është i regjistruar për të votuar në VV-në ku ai/ajo është duke shërbyer, atëherë anëtar i KVV- së duhet të votojë në VV-në e dyfishtë të vendosur në QV-në e njëjtë. Nëse VV-ja në të cilin anëtar i KVV- së është caktuar të votojë është afër, kryesuesi i KVV- së mund t’ia lejojë anëtarit të KVV- së të largohet nga VV-ja dhe të votojë në mënyrë të rregullt.

13.2 Kryesuesi i KVV- së duhet të sigurojë që vetëm një anëtarë i VV të mungojë në të njëjtën kohë për arsye të votimit nga VV.

Neni 14

Mbyllja e Vendvotimit

14.1 Çdo person në rresht në orën e mbylljes së VV-së, lejohet të votojë nëse ka zotësi juridike për të votuar. Kontrolluesi i rreshtit duhet ta informojë personin e fundit në rresht se ai/ajo do të jetë personi i fundit që do të votojë. Çdo person tjetër që i bashkohet rreshtit pas atij personi, nuk do të lejohet të hyjë në VV dhe informohet për pamundësnë e tij/saj për të votuar.

14.2 Pasi të votojë personi i fundit në rresht në kohën e përfundimit të votimit, Kryesuesi i KVV-së do ta mbyllë VV-në, e mbyll vrimën e lartë të kutisë së votimit, me shiritin mbyllës, në atë mënyrë që kjo të mund të shikohet nga vëzhguesit e pranishëm, dhe në Librin e Votimit e shënon kohën e saktë të mbylljes në Librin e Votimit.

Neni 15

Procesi i Numërimit në Vendvotimet e Rregullta

15.1 Procedurat e numërimit të fletëvotimeve të rregullta do të udhëheqen nga qëllimet e paraqitura: saktësia, transparenca, efikasiteti dhe mbrojtja e sigurisë së votës.

15.2 Pasi të mbyllet vendvotimi, Kryesuesi i KVV-së do të shënojë në Librin e Votimit; emrat, numrat e letërnjoftimeve dhe numrat e akreditimit të të gjithë vëzhguesve të akredituar e të pranishëm dhe do t’i informoj ata se nëse largohen nga VV-ja para se të përfundohet numërimi, ata nuk do të lejohen të kthehen.

15.3 Nëse ekipi i dytë i KVV-së për numrim do të caktohet për procesin e numërimit (nga tash e tutje: Ekipi i Numërimit), në pajtim me nenin 1.7 të kësaj rregulle zgjedhore, atëherë Kryesuesi i Ekipit të Numërimit së bashku me njërin nga anëtarët e ekipit të numërimit duhet të jenë të pranishëm në orën 19:00 në ditën e votimit për të monitoruar mbylljen e VV-së.

15.4 Në prani të Kryesuesit të Ekipit të Numërimit, anëtarët e KVV (tash e tutje Ekipit të Votimit) duhet të:

(a) llogarisin numrin e votuesve/nënshkrimeve në LPV dhe të shënojnë numrin e gjithmbarshëm në formularin përkatës të FPR-së;

- (b) numërojnë fletëvotimet e mbetura të papërdorura të zgjedhjeve përkatëse dhe të shënojnë numrin e tyre në formularin përkatës të FPR-së;
- (c) numërojnë fletëvotimet e dëmtuara për secilën zgjedhje, të shënojnë numrin e tyre në formularin përkatës të FPR-së dhe t'i vendosin ato prapë në zarfin e caktuar për fletëvotime të dëmtuara;
- (d) verifikojnë shiritat mbyllës dhe numrat e tyre serik në kutin e votimit dhe se nëse këta numra janë regjistruar si duhet në FPR; dhe
- (e) nënshkruajnë FPR-të para dorëzimit të të gjithë formularëve, materialin dhe kutitë e mbyllura të votimit tek Ekipi i Numërimit, nëse është formuar. Pastaj Ekipi i Votimit do ta lëshojë VV pas dorëzimit. Nëse Ekipi i Numërimit nuk është caktuar, i njëjti Ekip i Votimit do të vazhdojë procesin siç është definuar në vazhdim.

15.5 Pas kësaj, anëtarët e KVV-së duhet të përgatiten për numërimin e fletëvotimeve, si vijon:

- (a) ndajnë mënjane fletëvotimet e papërdorura, zarfet me fletëvotime të dëmtuara, vulën zyrtare të fletëvotimit dhe LPV-në;
- (b) vendosin të gjitha materialet shtesë për zyrë në një kontejner, përfshirë këtu lapsat ose markerat që mund të përdoren për shënimin e fletëvotimeve dhe ta vendosin atë mënjane; dhe
- (c) organizojnë hapësirën e numërimit në atë mënyrë që asnjë material të mos mbetet mbi tavolinë, ose në vendin e caktuar për numërim, përveç materialeve të nevojshme siç janë letra e bardhë e zbrazët, Libri i Votimit dhe FPR.

15.6 KVV-ja duhet t'i heqë shiritat mbyllës dhe të hapë vetëm një kuti të votimit në atë kohë. Nëse gjendet më shumë se një kuti e votimit, atëherë kutia tjetër e votimit duhet të hapet vetëm pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve që gjenden në kutinë e hapur të votimit. Rendi i numërimit të fletëvotimeve duhet të jetë i njëjtë në të gjitha VV-të.

15.7 Një anëtar i KVV-së e hap kutin e votimit dhe kthen përmbys mbi tavolinë, ose në ndonjë vend tjetër të caktuar për numërim dhe i nxjerrë fletëvotimet. Kryesuesi duhet të sigurojë që asnjë fletëvotim të mos mbetet brenda asaj kutie të votimit.

15.8 Për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe Zgjedhjet për Kuvendet Komunale vota e vlefshme është ajo e cila prezanton qëllimin e qartë të votuesit për subjektin politik për të cilin voton.

a) Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës votuesi do të votojë për një (1) subjekt politik të certifikuar dhe mund të votojë deri në pesë (5) kandidatë nga lista anësore e kandidatëve të subjektit politik, në pajtueshmëri me nenin 110 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Nëse fletëvotimi është shënuar me më shumë se pesë kandidatë, vetëm vota për subjektin politik do të konsiderohet e vlefshme dhe do të numërohet në përputhje me nenin 110.5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

b) Në zgjedhjet për Kuvende të Komunave, votuesi do të votojë për një (1) subjekt politik të certifikuar dhe mund të votojë për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve nga ky subjekt politik. Vota e hedhur për subjektin politik konsiderohet votë e hedhur për kandidatin e parë nga lista e kandidatëve nga ky subjekt politik. KQZ-ja do të sigurojë që fletëvotimi nuk do t'i lejojë votuesit që në të njëjtën kohë të votojë për Subjektin Politik dhe kandidatin e parë nga lista e kandidatëve nga ky Subjekt Politik në përputhje me nenin 7 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Nëse fletëvotimi është shënuar me më shumë se një (1) kandidat, vetëm vota për subjektin politik do të konsiderohet e vlefshme dhe do të numërohet në përputhje me nenin 7.4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale.

15.9 Për Zgjedhjet për Kryetar të Komunave votë e vlefshme konsiderohet atëherë kur votuesi e ka shënuar vetëm një kandidat në fletëvotim e cila prezanton qëllimin e qartë të votuesit.

15.10 Fletëvotimi për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, për Kuvendin Komunal dhe për Kryetar të Komunës do të konsiderohet i pavlefshëm, nëse:

- (a) në fletëvotim është shënuar më shumë se një subjekt politik;
- (b) mënyra sesi është shënuar fletëvotimi e bën qëllimin e votuesit të paqartë; ose
- (c) nuk është vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimit, kur është nxjerrë nga kutia e votimit.

Përveç kësaj, fletëvotimi për Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendin e Komunës do të konsiderohet i pavlefshëm, nëse:

- (d) votuesi e shënon vetëm kandidatin(ët) dhe jo Subjektin Politik.

15.11 Një fletëvotim konsiderohet fletëvotim i zbrazët, nëse fletëvotimi nuk është shënuar në kurrëfarë mënyre.

15.12 Nëse anëtarët e KVV-së nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është fletëvotimi i vlefshëm, i pavlefshëm ose i zbrazët, atëherë Kryesuesi duhet të marr vendimin përfundimtar përkitazi me atë fletëvotim.

15.13 Sipas udhëzimeve të Kryesuesit dhe anëtarët e KVV-së, duhet të:

- (a) kthejnë përmbys të gjitha fletëvotimet e nxjerra nga kutia e votimit dhe t'i numërojnë
- (b) rinumërojnë fletëvotimet, nëse numri i gjithmbarshëm i fletëvotimeve ndryshon nga numri i gjithmbarshëm i votuesve/nënshkrimeve në LPV:
 - (i) për më shumë se një (1), nëse numri i gjithmbarshëm i nënshkrimeve në LPV është më e vogël ose baraz me njëqind (100); ose
 - (ii) për më shumë se dy (2), nëse numri i gjithmbarshëm i nënshkrimeve në LPV është më i madh se 100, por më e vogël ose baraz me dyqind (200);
 - (iii) për më shumë se tre (3), nëse numri i gjithmbarshëm i nënshkrimeve është më i madh se dyqind (200).
- (c) shënojnë numrin e gjithmbarshëm të fletëvotimeve në formularin gjegjës të FPR-së;
- (d) pas numërimit të kënaqshëm të të gjitha fletëvotimeve të hedhura, t'i kthejnë mbarë fletëvotimet dhe t'i numërojnë votat për secilin subjekt politik dhe në FPR-në gjegjës, të shënojnë numrin e gjithmbarshëm të fletëvotimeve të vlefshme sipas subjekteve politike, pastaj fletëvotimet e zbrazëta dhe të pavlefshme.

15.14 Pas përfundimit të numërimit të fletëvotimeve të vlefshme që ka fituar secili subjekt politik, anëtarët e ekipit të KVV-së duhet që sipas udhëzimeve të Kryesuesit:

- (a) t'i numërojnë votat që u janë dhënë kandidatëve të secilit Subjekt Politik;
- (b) të plotësojnë formularin e rezultateve të kandidatëve (FRK) për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendin Komunal, një kopje e të cilit është bashkangjitur si Shtojcë III, duke e plotësuar emrin e subjektit politike, e shënojnë numrin e votave që ka fituar secili kandidat i atij subjekti politik; e plotësojnë FRK për çdo subjekt politik që ka fituar së paku një votë në ato zgjedhje;
- (c) të plotësojnë FPR-në gjegjëse përkitazi me fletëvotimet e vlefshme, të zbrazëta dhe të pavlefshme, si dhe t'i nënshkruajë formularët.

15.15 Pas përfundimit të numërimit të fletëvotimeve për një palë zgjedhësh, anëtarët e KVV-së duhet t'i paketojnë fletëvotimet e numëruara në një thes të tejdukshëm plastik dhe e vendos thesin aty ku mund të shihet nga të gjithë anëtarët e KVV-së dhe vëzhguesit, dhe ia heq shiritat mbyllës dhe e hap kutinë tjetër të votimit sipas rendit të përcaktuar në nenin 15.6 të kësaj rregulle zgjedhore.

15.16 Nëse anëtarët e KVV-së konstatojnë se fletëvotimet në një kuti të caktuar të votimit janë nga zgjedhje të tjera, ato fletëvotime numërohen dhe rezultati shënohet në FPR-në përkatëse.

15.17 Pas përfundimit të numërimit të fletëvotimeve për të gjitha zgjedhjet, anëtarët e KVV-së duhet ti mbyllin me shirit mbyllës plastik të gjitha paketot e fletëvotimeve, një pako për çdo zgjedhje, të

shënojë numrin serik të shiritit mbyllës plastik në FPR-në gjegjë, dhe të vendosë nga një thes brenda kutis së votimit.

15.18 Pastaj anëtarët e KVV-së, duhet t'i paketojnë materialet e mbetura si dhe formularët e rezultateve të zgjedhjeve dhe ti percjellin në KKZ në përputhje me udhëzime nga KKZ-ja në përputhje me Doracakun e Votimit dhe të Numërimit, si dhe t'i plotësojnë dhe nënshkruajnë FPR-të.

15.19 Kryesuesi i KVV-së do të jetë përgjegjës për përpilimin dhe saktësin e rezultateve të numëruara, të shënuara në formularin përkatës të Rezultateve.

Neni 16

Përputhja e të Dhënave të Zarfave me Kusht

16.1 Para procedurave të përcaktuara në nenin 15 të kësaj rregulle zgjedhore, procesi i përputhjes së të dhënave të Fletëvotimeve me Kusht duhet të bëhet në VV-të e Dyfishta.

16.2 Pas mbylljes së VV-së, KVV-ja duhet të zbatojë procedurat e njëjta siç përcaktohen në nenin 15 të kësaj rregulle zgjedhore për njësimin e numrit të emrave të votuesve në LVK dhe përgatitjet që duhet të bëhen para hapjes së kutisë së votimit me zarfe të fletëvotimeve me kusht.

16.3 Anëtari e KVV-ve duhet ta hap kutinë e votimit të caktuar për zarfet e fletëvotimeve me kusht dhe e kthen atë përmbys mbi tavolinë, ose në ndonjë vend tjetër të caktuar për numërim. Kryesuesi duhet të sigurojë që asnjë zarf i fletëvotimeve me kusht, zarf i pangjitur i fshehtësisë ose fletëvotim të mos mbetet brenda kutisë së votimit.

16.4 Anëtari e KVV-ve duhet t'i numërojë ndaras zarfet e pangjitura të fshehtësisë, nëse gjendet ndonjë në kutinë e votimit, dhe në secilën të shkruaj fjalën "e pavlefshme".

16.5 Sipas udhëzimeve të kryesuesit, anëtarët e KVV-së duhet të:

- (a) numërojnë zarfet e fletëvotimeve me kusht që gjenden në kuti të votimit;
- (b) rinumërojnë zarfet e fletëvotimeve me kusht nëse numri i gjithmbarshëm i tyre ndryshon prej numrit të gjithmbarshëm të emrave në Listën e votuesve me kusht për më shumë se 1; dhe
- (c) shëno numrin e gjithmbarshëm të zarfeve të fletëvotimeve me kusht në FPR-të gjegjëse. Shëno numrin e nënshkrimeve të LVK në FPR përkatëse dhe shëno 0410D numrin e zarfeve të pangjitura të fshehtësisë në Librin e Votimit.

16.6 Pas përfundimit të numërimit, anëtarët e KVV-së duhet t'i paketojnë zarfet e numëruara të fletëvotimeve me kusht dhe zarfet e pangjitura të fshehtësisë në thesin e caktuar dhe ta vendosin atë në vendin ku mund të shihet nga anëtarët e KVV-së dhe vëzhguesit e pranishëm deri në përfundimin e numërimit të fletëvotimeve të rregullta, siç është e definuar në nenin 15 të kësaj rregulle.

16.7 Nëse zarfi i fletëvotimeve me kusht ose zarfi i pangjitur i fshehtësisë është vendosur gabimisht në një kuti votimi të caktuar për fletëvotime të rregullta, atëherë, në fund të numërimit, zarfet e fletëvotimeve me kusht duhet të numërohen dhe numri i zarfave të fletëvotimeve me kusht do të shënohet në FPR-në përkatëse, dhe Zarfat e Fshehtësisë të pangjitur do të numërohen, shpallen jo të vlefshme dhe shënohen në Librin e Votimit siç është caktuar në nenin 16.4 të kësaj rregulle .

16.8 Pas përfundimit të numërimit të fletëvotimeve të rregullta, anëtarët e KVV-së do ta paketojnë materialin siç i ka udhëzuar KKZ-ja, dhe në pajtushmëri me Doracakun e Votimit dhe Numërimit.

Neni 17

Procedurat pas Numërimit të Fletëvotimeve ose Përputhja e të Dhënave të Zarfeve të Fletëvotimeve me Kusht

17.1 Pas përfundimit të numërimit të fletëvotimeve dhe përputhjes së të dhënave të zarfeve të fletëvotimeve me kusht, Kryesuesi i KVV-së duhet të:

- (a) lejojë që vëzhguesit e akredituar të pranishëm të kopjojnë informata nga FPR-të dhe të FRK-së për përdorim të tyre, nëse e kërkojnë një gjë të tillë;
- (b) do të vendos rezultatet e procesit të numrimit në QV, dhe
- (c) informojë anëtarët e KVV-së se ata lejohen të largohen, por se mund të thirren sërish nëse nga KKZ-ja kërkohet ripërputhja e të dhënave të materialeve;

17.2 Në pajtushmëri me udhëzimet e KKZ-së çdo Kryesues i KVV-së do ta shoqëroj transportimin e sigurt të fletëvotimeve dhe materialit zgjedhorë nga VV deri te lokacinet e KKZ-së, e aranzhuar ekskluyivisht nga KKZ-ja. Nëse kërkohet, shoqërohet edhe nga një anëtar i opozitës i nivelit përkatës, i zgjedhur me konsensus, ose në mungesë të konsensusit, i zgjedhur me short nga Kryesuesi.

17.3 Çdo Kryesues i KVV-së duhet t'i dorëzojë materialet nga VV-të e tyre tek KKZ-ja, në pajtushmëri me udhëzimet e Dorzimit/Pranimit nga KKZ-së. Nëse KKZ-ja identifikon gabimet që lidhen me paketimin ose numërimin e materialeve të ndjeshme, KKZ-ja mund të ndërmarrë çfarëdo mase korrigjuese, përfshirë këtu urdhërimin e paketimit ose të përputhjes së sërishme të zarfeve të Fletëvotimeve me Kusht. Asnjë rinumërim i fletëvotimeve të rregullta nuk do të ndërmirret në nivelin e KKZ-së. KKZ-ja shënon korrigjimet në formularin e FPR-së ose në dokumente tjera me laps me ngjyrë tjetër që është përdorur nga KVV-ja. Krahas këtyre ndryshimeve KKZ-ja duhet të shënojë numrin e tij/saj të numrit personal të SKQZ-së dhe inicialet e tij/saj.

17.4 Nëse pakëtimi i sërishëm i materialeve është i nevojshëm, KKZ-ja do të mbyllë pakot e reja para Kryesuesit të KVV-së dhe do të shënojë numrin(at) e ri të shiritit mbyllës në FPR-të gjegjëse, me laps me ngjyrë tjetër nga ai i cili është përdorë nga KVV-ja. Krahas këtyre ndryshimeve KKZ-ja duhet të shënojë numrin e tij/saj të DI të SKQZ-së dhe inicialet e tij/saj.

17.5 Kryesuesi i KVV-së lejohet të lëshojë hapsirat e KKZ-së, nëse të gjitha procedurat e dorzimit janë përcjellur dhe anëtari i KKZ-së e informon atë se ai/ajo lejohet të largohet. Kryesuesi i KVV-së i cili largohet para se të marrë lejen do të sanksionohet në pajtim me rregullën zgjedhore nr. 14/2009 të Sanksioneve dhe Gjobave.

17.6 Anëtarët e KKZ-së do të përpilojnë në verzion elektronik të gjitha rezultatet nga formularët e FPR-së brenda komunës së tyre, dhe do të ja dërgojnë këtë dokument në SKQZ, në pajtim me udhëzimet e dhëna nga Koordinatori i Terenit të SKQZ-së.

Neni 18

Dorëzimi nga KKZ-të tek Qendra e Numrimit dhe Rezultateve (QNR)

18.1 Transportimi i sigurtë i materialeve nga KKZ-ja në QNR do të jetë në pajtim me afatet kohore dhe udhëzimet nga SKQZ-ja.

18.2 Procedurat e pranimit në QNR siç përcaktohen në rregullën zgjedhore 06/2008 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve dhe procedurat teknike të QNR-së do të ndiqen.

18.3 KKZ-ja i cili e përcjell materialin nga KKZ për në QNR do të lejohet ta lëshojë hapsirën e QNR-së, nëse të gjitha procedurat e dorzimit janë përcjellur dhe personeli përgjegjës i QNR-së e informon atë se mund të largohet. Anëtari i KKZ-së që largohet para se të marrë lejen do të sanksionohet në bazë të rregullës zgjedhore nr. 14/2009 mbi Sanksionet dhe Gjobat.

Neni 19

Ankesat

19.1 Ankesat përkitazi me procesin e votimit dhe numërimit në vendvotime duhet të dorëzohen në PZAP brenda 24 orëve nga mbyllja e vendvotimeve dhe për ato do të vendos PZAP-I Brenda 72 orëve pasi që ankesa është pranuar, në pajtim me nenin 119.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 28 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale dhe Rregullat e Punës së PZAP-it.

19.2 Dorëzimi i ankesës nuk do ta ndërprejë ose pezulloj procesin e numrimit.

19.3 Cili do anëtarë i KKV-së i cili anëkohet për rezultatet e shënuara në VV mund ta shënojë mendimin e vet mospajtues në Librin e Votimit dhe mund të parashtrij ankesën në PZAP.

Neni 20 Përsëritja e Votimit

Para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëzakonshme të anulojë rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhërojë KOZ-në të përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale, në përputhje me nenin 120.1 (b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenit 28 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale. Në këtë rast të njejtat rregulla do të aplikohen për përsëritjen e votimit.

Neni 21 Hyrja në Fuqi

Kjo Rregull e ndryshuar zëvendëson Rregullën e mëparshme për Votimin dhe Numërimin në Vendvotim, dhe dispozitat që përkasin në nivelin e KKZ-ve, dhe hyn në fuqi më 25.06.2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
